



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:131383
Datë: 22.01.2024
Numri i dokumentit: 05220740

C.nr.540/17

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, Gjyqtari Shaban Shala, me bashkëpunëtorin profesional V.D. në çështjen kontestimore-juridike të paditëses Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike, Sh.A (KEDS), me seli në Prishtinë - Distrikti në Prizren, të cilën me autorizim e përfaqëson zyrtare ligjore G.H. nga Prizreni, kundër të paditurit B.S.E. nga fshati Komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqëson av. M.Q. me objekt të padisë kompensimi dëmi, vlera e kontestit 4,759.44 €, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik, më datë 13.12.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditëses **Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike, Sh.A (KEDS)**, me seli në Prishtinë - Distrikti në Prizren, ashtu që **DETYROHET** i padituri B.E. nga fshati Komuna e Prizrenit që paditëses t'ia paguajë shumën prej 4,759.44€ në emër të kompensimit të dëmit material me kamatë ligjore 8% duke filluar nga dita e parashtrimit të padisë (20.06.2019) e gjer në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënim të ekzekutimit të detyrueshëm.

II. REFUZHET si e pa bazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike, Sh.A (KEDS), me seli në Prishtinë - Distrikti në Prizren, mbi shumën e aprovuar si në dispozitivin I të këtij aktgjykimi, e deri tek shuma e kërkuar në lartësi prej 16.385,64€ (gjashtëmbëdhjetë mijë e treqind e tetëdhjetë e pesë euro e gjashtëdhjetë e katër cent), në emër të kompensimit të dëmit material.

III.DETYROHET i padituri që paditëses t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 100.00 € (njëqind euro) në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënim të ekzekutimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A (KEDS) me seli në Prishtinë – Distrikti në Prizren, pranë kësaj gjykate me datë 20.06.2019 ka parashtruar padi, kundër të paditurit B.E. nga fshati Komuna e Prizrenit, për shkak të kompensimit të dëmit material.

Paditësja në padi, gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe fjalës përfundimtare, përmes të autorizuarës së saj G.H. ka deklaruar se : mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë si dhe pranë të gjitha deklarimeve të theksuara në seancat e mbajtura duke i propozuar gjykatës që ta aprovojë në tërësi kërkesëpadinë në vlerë prej 16.385,64€. Gjithashtu ka theksuar se i padituri është shpallur fajtor në procedurë penale sipas vendimit P.nr.363/16 të datës 21.11.2016, i plotfuqishëm me datën 06.01.2017 në bazë të cilit edhe është paraqitë padi në vlerën 16.385,64 €, të përcaktuar sipas faturës së rikthimit të humbjeve nr. DPZ15HP09624 të datës 17.06.2015 ndërsa ekspertizën e ekspertit M.Gj. e konsideron se është në kundërshtim të plotë me gjendjen faktike të konstatuar në teren sipas procesverbalit me nr. 0436901 të datës 16.06.2015 nga ekipet e KEDS, sepse duke pas parasysh që në procesverbalin në të cilin është përshkruar keqpërdorimi i energjisë elektrike janë shënuar të gjitha pajisjet që janë hasur në objekt duke shpenzuar energji elektrike e cila nuk është regjistruar dhe faturuar ku edhe ka shkuar në dëm të paditurës dhe ky procesverbal është nënshkruar nga ana e konsumatorit që nënkupton se i njëjti është pajtuar me shënimet në procesverbal dhe të gjitha pajisjet e shënuara në të. E njëjta e ka kundërshtuar ekspertizën e ekspertit M.Gj. duke konsideruar se e njëjta është joprofesionale dhe ka mangësi në mënyrën e interpretimit të normave të procedurës së identifikimit dhe parandalimit të paautorizuar të energjisë elektrike për kalkulimin e rikthimit të humbjeve dhe nuk merr për bazë gjendjen faktike të konstatuar në terren për sa i përket keqpërdorimit të energjisë elektrike si dhe provat e administruara në këtë çështje kontestimore. Andaj i ka propozuar gjykatës që ekspertizës së ekspertit të mos i'a falë besimin për arsyet e lartcekura pasi që e njëjta është në kundërshtim me gjendjen faktike dhe ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses ta aprovojë në tërësi si të bazuar në vlerën e shkaktuar të dëmit si në padi në shumë prej 16.385,64€. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë në emër të taksës gjyqësore shumë prej 100.00€.

I autorizuari i të paditurit av. M.Q. në përgjigje në padi, gjatë shqyrtimeve gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: e kundërshton në tërësi kërkesëpadinë e paditësit dhe se nga provat e administruara në këtë çështje nuk është arritur të vërtetohet baza juridike e kërkesëpadisë, e as lidhja kauzale në mes shkakut dhe pasojës, e kjo për faktin se nga shkresat e lëndës si procesverbali me nr. 0436901 është konstatuar se shfrytëzues është piceria “Te Bisa”, me pronar B.B. gjithashtu edhe në shkresat tjera siç është kallëzimi penal ku vet pala paditëse e ka iniciuar procedurën penale të njëjtet kanë theksuar se shfrytëzues është piceria te Bisa. Gjithashtu ka theksuar se i padituri nuk ka pas asnjë interes dhe nuk është pronar juridik i biznesit lokal në të cilin është vendosur njehsori që pretendohet se është manipuluar është i tij, mirëpo ai energjinë elektrike nuk e ka shfrytëzuar për vete mirëpo të njëjtën e ka shfrytëzuar pronari i biznesit. Gjithashtu ka theksuar se në këtë proces nuk është arritur të vërtetohet lartësia e kërkesës ashtu siç është kërkuar në petitumin e kërkesëpadisë ngase prova e nxjerrë me ekspertizë të elektro-teknikës ka nxjerrë një vlerë tjetër nga ajo e pretenduar në padi. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë për 6 seanca të mbajtura shumë prej 1.212 euro, për çdo seancë shumë prej 202 euro, si dhe 156 euro për përgjigjen në padi.

Për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike dhe fakteve vendimtare gjykata ka administruar provat si në vijim: ka bërë leximin e aktgjykimit P.nr. 363/16 të datës 21.11.2016, së bashku me faturën për rikthimin e humbjeve të datës 17.06.2015, është bërë leximi i transaksioneve të konsumatorit për B.E. e datës 07.12.2022, leximi i kallëzimit penal të datës 17.09.2015, është bërë leximi i procesverbalit të KEDS, nr. 0436901 të datës 16.06.2015, së bashku me tri fotot e njëhësorit, leximi i faturës për rikthimin e humbjeve të datës 17.06.2015, dhe është bërë leximi i ekspertizës së elektros të ekspertit M.Gj. e datës 14.06.2023, andaj gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e bazuar.

Nga leximi i aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren P.nr.363/2016 të datës 21.11.2016, i plotfuqishëm me dt.06.01.2017, gjykata ka vërtetuar se i padituri është shpallur fajtor për shkak se prej datës së pavërtetuar e deri me dt. 16.02.2015 i padituri B.E. (i akuzuar në atë kohë) ka bërë shfrytëzimin e paautorizuar të energjisë elektrike me ç ‘rast ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP-së

Nga leximi i faturës DPZ15HP09624 dt.17.06.2015, gjykata ka vërtetuar faktin e llogaritjes së shumës së dëmit për rikthimin e humbjeve sipas kalkulimit të palës paditëse, lartësia e së cilës është 16.385,64 €.

Nga leximi i transaksioneve të konsumatorit për B.E. DPZ - 9029281 e datës 07.12.2022, gjykata ka vërtetuar gjendjen e borxhit dhe të pagesave për konsumatorin – këtu të paditurin për periudhën 31.12.2012 deri me datë 25.11.2022 nga e cila rrjedhë se ekziston dhe borgji sipas faturës për rikthimin e humbjeve.

Nga leximi i kallëzimit penal të datës 17.09.2015, parashtruar nga Prokuroria Themelore në Prizren, gjykata ka vërtetuar faktin se ndaj këtu të paditurit është parashtruar kallëzim penal për shkak të dyshimit se ka kryer veprën penale-vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të LPK-së.

Nga leximi i procesverbalit të KEDS, nr. 0436901 të datës 16.06.2015, gjykata ka vërtetuar faktin se ekipet e KEDS-it, gjatë kontrolles tek konsumatori kanë hasur në keqpërdorim të energjisë elektrike, duke konstatuar se njëhësori elektrik është pa bllobbë distribuive, gjithashtu i ka të larguara tri urat e tensionit që do të thotë se energjia elektrike nuk është matur (faturuar).

Nga foto dokumentacioni 4 foto, gjykata ka vërejtur se njëhësori elektrik është pa bllobbë distribuive gjithashtu i ka të larguara tri urat e tensionit të hasur tek konsumatori në momentin e kontrollës nga ana e ekipeve të KEDS-it.

Nga leximi i kalkulimit të rikthimit të humbjeve me ID të rastit 9865 dt.17.06.2015, gjykata ka vërtetuar se pala paditëse ka bërë kalkulimin e rikthimit të humbjeve në bazë të fuqisë së pajisjeve të cilat janë hasur në përdorim tek i padituri në momentin e kontrolles dhe kalkulimi i rikthimit të humbjeve është bërë për 12 muaj.

Nga ekspertiza nga lëmia e elektros e punuar nga eksperti M.Gj. e dt. 14.06.2023, gjykata ka konstatuar se eksperti ka përpiluar ekspertizën e tij bazuar në procedurat për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike fillimisht ka

konstatuar se njësonit elektrik nr.36240317 i mungojnë pllombat distribuove dhe urat e tensionit janë të hapura, se një manipulim i tillë paraqet shfrytëzim të pa autorizuar të energjisë elektrike, se rikthimi i humbjeve është bërë në bazë të procesverbalit nr.0436901, se pajisjet Furra e Picave dhe Frizi janë pajisje të reja të sapomontuara një ditë para konstatimit të shfrytëzimit të pa autorizuar, ku në bazë të cilave konstatime ka ardhur në përfundim se pas ndërrimit të njësonit elektrik dhe vendosjes së njësonit të ri, ku mesatarja mujore e hargjimit të regjistruar dhe faturuar është 4755.50 kwh, duke marrë parasysh faturat e blerjes së pajisjeve një ditë para konstatimit të shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike (duke llogaritur këto pajisje sepse llogaritja rikthimit të humbjeve bëhet nga muaji Maj i vitit 2015 e prapa) fatura e rikthimit të humbjeve për 12 muaj është 4.759,44€. Eksperti edhe në shqyrtimin gjyqësor të dt.24.10.2023 ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë mendimit të dhënë sikurse në ekspertizë dhe posaçërisht pranë konstatimit se fatura për rikthimin e humbjeve për 12 muaj është 4,759.00 € duke llogaritur dhe TVSH prej 16%. Ndërsa nga pyetjet e parashtruara nga palët ka sqaruar përpos tjerash faktin se furra e picave dhe frigoriferi nuk kanë qenë në përdorim një vjeçar siç është kalkuluar në faturën për rikthimin e humbjeve, kështu që pas zbritjes së fuqisë së furrës së picave dhe një frizi ka llogaritur fuqinë maksimale të angazhuar prej prej 9.48 kw dhe pas kalkulimeve të nevojshme ka përcaktuar shumën sikurse në ekspertizë. Kësaj ekspertize dhe deklarimit të ekspertit në shqyrtimin kryesor sipas të cilit në fuqinë e angazhuar duhet të zbritet fuqia e angazhuar e furrës për pica dhe një frizi për gjykatën është plotësisht e pranueshme sepse nga fatura nr.103/2015 vërtetohet fakti se më dt.15.06.2015 DPH “Te Bisa”, ka blerë furrën për pica në shumën prej 480 € nga NP “FRIGO STAR”, ndërsa nga fatura nr.104/2025 vërtetohet fakti se më dt.15.06.2015 DPH “Te Bisa”, ka blerë një frizë të thjeshtë për pica në shumën prej 490 € nga NP ”FRIGO STAR” dhe kur të merret për bazë në anën tjetër fakti se fatura e rikthimit të humbjeve mbanë dt.17.06.2015, pra 2 ditë pas blerjes së pajisjeve të cekura si më lartë kësaj prove në tërësi ia fali besimin ngase është hartuar në mënyrë profesionale dhe me bazë ligjore.

Bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar me lartë dhe duke u bazuar në nenin 136 par. 1. të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), i cili përcakton: **“Kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë ta kompensoj, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij”**. Në bazë të kësaj pala përgjigjet për dëmin e shkaktuar me dashje dhe nga pakujdesia. Çështja e përgjegjësisë subjektive është rregulluar në bazë të nenit 136 par. 1. dhe lidhur me nenin 140 të LMD, me të cilin është përcaktuar se **“Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia”**, ndërsa me nenin 245 të po këtij ligji është përcaktuar se **“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”**, andaj duke u bazuar në të dhënat e cekura sikurse më lartë gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar pjesërisht kërkesë padinë.

Pas analizimit dhe vlerësimit të provave të lartcekura, gjykata konstatoi se i padituri i ka borxh paditëses shumën në lartësi prej 4,759.44€ në emër të kompensimit të dëmit për shfrytëzimin e energjisë elektrike në mënyrë të paautorizuar, të cilin fakt, pra bazën juridike gjykata e vërtetoi nga aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren P.nr.363/2016 dt.21.11.2016, i plotfuqishëm me dt.06.01.2017 me të cilin i padituri është shpallur fajtor për keqpërdorim të energjisë elektrike, konkretisht për veprën penale vjedhje e shërbimeve e sanksionuar me nenin 320 të KPK-së, ndërsa sa i përket lartësisë u vendos bazuar në ekspertizën e ekspertit të elektros.

Lidhur me pjesën tjetër të kërkesëpadisë të cilën kjo gjykatë e refuzon si të pabazuar, gjykata në bazë të provave dhe fakteve të vërtetuara konsideron se shumica e kërkuar dhe e llogaritur nga ana e paditëses në faturën me nr. DPZ15HP09624 dt.17.06.2015, përtej vlerës së aprovuar në pikën II të dispozitivit, është e pa bazuar sepse dëmi i shkaktuar nga ana e të paditurit është vërtetuar nga ekspertiza e ekspertit të dt.14.06.2023 dhe deklarimi i ekspertit në shqyrtimin kryesor të datës 24.10.2023 të cilave gjykata ia fali besimin e plotë.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (20.06.2019), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala i padituri është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Gjykata konform nenit 452.2 të LPK-së, vendosi që i padituri, ti paguaj paditëses shpenzimet e procedurës dhe atë për taksën gjyqësore për padi shumën prej 100.00 € (njëqind euro).

Nga të lartcekurat dhe bazuar në nenin 143 të KPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN
-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM –
C.nr.540/17, dt. 13.12.2023**

B. Profesionale

Gjyqtari

Valmira Dakaj

Shaban Shala

KËSHILLË JURIDIKE: kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 15 ditëve, pas pranimit të tij, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.